

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria
(Zgjidhjet)**

P10

Data 12/10/2019

Detyra 1

(a) Numëroni dhe përshkruni PESË pohime që kanë të bëjnë me klasët e transaksioneve dhe gjendjen e llogarive për të hyrat dhe llogaritë e arkëtueshme. **(8 pikë)**

(b) Ju jeni senior i auditimit i ngarkuar në auditimin e Printi, një kompani që shet materiale zyreje dhe jeni duke kryer auditimin e për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018. Provizionet për llogaritë e arkëtueshme të kompanisë llogaritet si përqindje standarde bazuar në përvojën historike të pagesave nga konsumatorët. Ju tashmë e keni përfunduar auditimin e provizioneve specifike. Menaxhmenti ka përdorur procesin e njëjtë për të provizionuar llogaritë e arkëtueshme sikur se vitin e kaluar. Si pjesë e procedurave të vlerësimit të rrezikut, ekipi i angazhimit të auditimit ka identifikuar rreziqet e anomalive materiale që lidhen me pohimin e vlerësimit:

- Entiteti nuk azhurnon si duhet provizionet për llogaritë e arkëtueshme për ndryshimet në rrethana nga viti në vit. Ekipi i angazhimit ka marrë dëshmitë në vijim nga procedurat e kryera:
 1. Edhe pse llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit janë më të larta se në vitin e kaluar, provizionet e këtij viti si përqindje e llogarive të arkëtueshme bruto janë konsistente me vitet e kaluara.
 2. Shpenzimi i borxhit të keq në pasqyrën e të ardhurave lidhur me provizionin specifik të llogarive të arkëtueshme ka mbetur konsistent si përqindje e llogarive të arkëtueshme bruto për disa vite me rradhë.
 3. Një rishikim për mbledhshmërinë e llogarive të arkëtueshme ka zbuluar se provizionet e bëra nga menaxhmenti kanë qenë të sakta.
 4. Kushtet ekonomike kanë qenë relativisht stabile dhe parashihet të mbesin ashtu.
 5. Të hyrat janë rritur në mënyrë domethënëse vit pas viti si rezultat i linjave të produkteve të reja.
 6. Linjat e reja të produkteve i dedikohen kryesisht sektorit të edukimit veçanërisht për kolegjet private dhe shkollat e mesme.
 7. Sektori i kolegjeve private dhe shkollave të mesme aktualisht ka një normë më të lartë të dështimit në biznes se sa bizneset tjera.
 8. Mbledhshmëria e llogarive të arkëtueshme kryesisht është bazuar në konsumatorët e sektorit ligjor dhe të kontabilitetit; entiteti ka shumë pak përvojë në historinë e përqindjes së mbledhjes së llogarive të arkëtueshme për linjat e reja të produkteve, për shkak se janë lansuar tani vonë.
 9. Kushtet e aprovuara të pagesës nuk kanë ndryshuar prej vitesh (psh personeli i shitjes mund të ofroj vazhdim të afatit të pagesës deri në 100% të vlerës së faturës, ngjashëm me vitet e kaluara, aftësia e pagesës së konsumatorëve përcaktohet në mënyrë të njëjtë dhe kushtet e pagesës kanë mbetur të njëjta nga viti në vit).
 10. Një përqindje më e madhe e shitjeve më afat pagese bëhet për kolegjet private se sa për sektorët tjerë.
 11. Konkurrenca që ofron mallrat e ngjashme kanë përqindje më të lartë të provizioneve se sa kompania Printi.
- [Shënim: ekipi i angazhimit mund të ketë identifikuar edhe rreziqe tjera të anomalive materiale lidhur me pohimin e vlerësimit, mirëpo nga ju kërkohet të konsideroni vetëm rreziqet e mësipërme. Nuk ka dëshmi për sjellje që mund të çojnë në ndonjë mashtrim nga kompania].

Kërkohet:

Për rastin e mësipërm:

(i) Bazuar në faktet e rastit, përcaktoni nëse mund të mbështeteni në dëshmitë e pranuar për vlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe rekomandoni çfarë informata shtesë ju nevojiten për të arritur në përfundim për pohimin e vlerësimit. **(9 pikë)**

(ii) Kritikoni metodën e mirënjohur të përfuturit të dëshmive përmes 'konfirmimit të llogarive të arkëtueshme'. **(8 pikë)**

[Total = 25 pikë]

Zgjidhja

(a)

Pohimet për klasët e transaksioneve	- Të gjitha transaksionet e shitjes kanë ndodhur dhe kanë të bëjnë me entitetin (ndodhja) - Të gjitha transaksionet e shitjes të cilat është dashur të regjistrohen, janë regjistruar (plotësia) - Shumat që kanë të bëjnë me transaksionet janë regjistruar në mënyrë të duhur (saktësia) - Të gjitha transaksionet janë regjistruar në periudhën e duhur (prerja) - Të gjitha transaksionet janë regjistruar si duhet (klasifikimi)
Pohimet për balancat e llogarive në fund të periudhës	- Të arkëtueshmet e regjistruara ekzistojnë (ekzistenca) - entiteti kontrollon të drejtat mbi të arkëtueshmet dhe llogaritë përkatëse (të drejtat dhe obligimet) - Të gjitha të arkëtueshmet të cilat është dashur të regjistrohen janë regjistruar (plotësia) - Të arkëtueshmet janë përfshirë në llogari me shuma të sakta (vlerësimi dhe shpërndarja)

(b)

(ii) Nga informatat e mësipërme, duket se pohimi i vlerësimit për të arkëtueshmet nuk është i mbështetur apo mungesa e dëshmive tjera do të çonte në moszbulimin e anomalive materiale në fushën e llogarive të arkëtueshme.

Na është thënë se të hyrat janë rritur në mënyrë domethënëse gjatë vitit. Mirëpo, na duhet të dijmë nëse kjo rritje është 15% ose 50%. Sa më e lartë të jetë rritja aq më i lart do të duhej të ishte lejimi për LLA.

Na duhet të dijmë më shumë për tregun e kolegjeve private dhe shkollave tjera për të parë nëse LLA nga këta konsumatorë janë më të ndjeshme ndaj mospagesës. Ne duhet të që grumbullojmë dëshmi shtesë për industrinë e ofruesve të trajnimit/shkollva/kolegjeve për të krijuar një pritje për normën e dështimit të tyre dhe si rrjedhojë aftësinë e pagesë së tyre.

Duke supozuar se ky nuk është klient i ri i firmës tonë dhe duke qenë të kujdesshëm të mbajmë skepticizmin tonë profesional në nivelin e duhur, ne duhet të bazohemi në: vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut, vlerësimin tonë të integritetit të menaxhmentit, dëshmitë tjera të pranuar nga fushat tjera të auditimit, materialitetin e llogarive të arkëtueshme dhe faktin nëse klientit duhet ti rezervohet opinioni.

Nëse ky është klient i ri dhe nuk kemi informata të mjaftueshme fillestare, me siguri do ta trajtonim si klient me rrezik të lartë.

(b) Konfirmimi i llogarive të arkëtueshme konsiderohet si njëra nga procedurat më të dobishme për të përfutur dëshmi nga klienti. Kjo për faktin se dëshmitë e përfutura përmes konfirmimit janë të pavarura nga klienti dhe janë në formë të shkruar. Kjo është e vërtetë. Mirëpo, kjo dështon të tregoj për pengesat e kësaj teknike. Së pari kjo teknikë merr shumë kohë. Kërkon nga auditori të vendos se cilat saldo të do të konfirmohen. Kërkohet që konfirmimet të dërgohen por edhe të ndjekën ato që nuk janë pranuar. Kërkohet që konfirmimet të analizohen dhe në fund të arrihet në një përfundim.

Problemi më i madh këtu është që auditori mbështetet në bashkëpunimin e konsumatorit të klientit. Konsumatori në këtë rast nuk ka asnjë obligim ti asistoj auditorit, prandaj mund të vendos të mos kthej konfirmimin. Kjo do të thotë se auditori duhet të përdor procedura tjera të auditimit për të verifikuar LLA. Në rastin kur konsumatorët përgjigjen në kërkesa, përgjigja e pranuar nga ata kryesisht është diçka që auditori e ka ditur. Konsumatorët që kthejnë kërkesat për konfirmim kryesisht janë konsumatorë që kanë një marrëdhënie të mirë me klientin, ata që kryesisht kanë histori të mirë kreditore me klientin, etj. Mirëpo, në anën tjetër konsumatorët që kanë dështuar të paguajnë me kohë ose kanë probleme financiare ose mosmarrëveshje me klientin ka gjasë të madhe të mos konfirmojnë kërkesën nga auditori. Edhe në këtë rast pranimi ose mos pranimi i konfirmimit do të na jep një informatë të cilën tashmë e kemi ditur.

Detyra 2

Ju jeni menaxheri senior në Mata, një firmë e auditorëve. Ju jeni i angazhuar si rishikues i kontrollit të cilësisë për angazhimet e firmës tuaj. Nga ju është kërkuar të rishikoni dosjet e auditimit të klientëve Sasa dhe Koko, të dy këto kompania kanë vit fiskal me 31 dhjetor 2018 dhe të dy auditimet janë afër përfundimit.

Sasa është përpunues i ushqimit të ngrirë, që shet produktet e saj te shitësit me shumicë dhe supermarketet. Nga rishikimi juaj i dosjes së auditimit, ju keni vërejtur se materialiteti është përcaktuar në €1.5 milion në fazën e planifikimit dhe ky materialitet është përdorur përgjatë tërë auditimit. Nuk ka ndonjë dëshmi në dosjen e auditimit se ky nivel i materialitetit është rishikuar/rivlerësuar gjatë auditimit. Nga rishikimi i planifikimit të auditimit, ju e dini që makina e re e paketimit me kosto €1.6 milion ishte blerë nga Sasa në mars të vitit 2018 dhe ishte njohur në pasqyrën draft të pozicionit financiar me vlerë bartëse prej €1.4 milion me 31 dhjetor 2018. Makina e paketimit gjendet në lokalet e Arra Shpk, një kompani e shpërndarjes e cila përdoret për të paketuar një sasi të konsiderueshme të produkteve të Sasa. Makina nuk është verifikuar fizikisht nga anëtarët e ekipit të auditimit. Letrat e auditimit përfundojnë se 'ne kemi marrë faturën e blerjes dhe porosinë për makinën, prandaj mund të përfundojmë se pasuria është vlerësuar si duhet dhe ekziston. Përveç kësaj, drejtori menaxhues i Arra ka konfirmuar me shkrim se makina gjendet në lokacionin e tyre dhe është në gjendje të mirë. Nuk ka nevojë për ndonjë punë shtesë të auditimit për këtë artikull'.

Stoqet në pasqyrat financiare kanë vlerën prej €2 milion. Ju keni rishikuar rezultatet e procedurave të auditimit që janë kryer në procesin e numërimit të stoqeve dhe si rezultat i testeve të kontroleve ekipi i angazhimit ka shënuar se numërimi i disa artikujve nga personeli i Sasa nuk është bërë si duhet. Letrat e punës tregojnë 'numërimi i stoqeve nuk ishte organizuar mirë' dhe arrijnë në përfundim 'mirëpo, shmangiet ishin jomateriale, prandaj nuk kërkohet ndonjë procedurë shtesë e auditimit'.

Seniori i auditimit bisedoi me ju dhe paraqiti disa shqetësime lidhur me kryerjen e auditimit. Përmbledhja e komenteve të tij është paraqitur në vijim:

'Menaxheri i auditimit dhe partneri i angazhimit erdhën të rishikojnë punën e auditimit në ditën e fundit të punës në terren. Partneri i auditimit më pyeti nëse ka pasur ndonjë çështje në fushat e auditimit në të cilat kisha punuar, dhe kur unë thashë se nuk kishte pasur probleme, ai nënshkroi letrat e punës pasi një shikimi të shpejtë të tyre. Gjatë leximit të procesverbaleve të takimit të bordit, gjeta disa referenca ndaj partnerit të angazhimit, Ardit Kuka. Duket se Ardit kishte rekomanduar përdorimin e shërbimeve të vëllait të tij Kelit për këshilla për zhvillim biznesor, pasi që Keli ishte konsulent menaxherial. Bazuar në rekomandimet, Keli kishte ofruar këshilla menaxheriale për Sasa në shtator 2018. Ja përmenda këtë Arditit dhe ai më tha të mos e shënoi këtë fakt në letrat e punës dhe as të mos e diskutoja me askë'.

Kërkohet:

Komentoni mbi cilësinë e auditimit të kryer duke diskutuar kontrollin e cilësisë dhe çështjet etike dhe profesionale. **(13 pikë)**

(b) Koni Shpk punon në kontratat e dizajnit dhe prodhimit të pasijjseve medicinale siç janë makinat e radioterapisë dhe të rendgenit. Kompania është specializuar në dizajnin, prodhimin dhe instalimin e makinave me porosi sipas kontratave me konsumatorët individual, që zakonisht janë kompani private medicinale. Pasqyrat financiare draft paraqesin fitim para tatimit prej €950,000 dhe pasuri totale prej €7.5 million. Seniori i auditimit ka lënë shënimin në vijim:

‘Njëri nga konsumatorët kryesor është Spitali Internacional (SI), një spital privat. Në qershor të 2018 ishte nënshkruar kontrata, sipas së cilës Koni Shpk do të dizajnonte një makinë të raditerapisë për SI. Makina është bazuar në inovacione të reja dhe është duke u zhvilluar për kërkesat specifike të SI. Është vlerësuar se dizajni dhe prodhimi i makinës do të zgjaste 16 muaj për tu instaluar në dhjetor të vitit 2019. Me 31 dhjetor 2018, Koni kishte investuar shumë në këtë kontratë dhe kosto të dizajnit në vlerë prej €350,000 ishin njohur si punë në proces në draftin e pasqyrës së pozitës financiare. Të hyrat e shtyra prej €200,000 gjithashtu janë njohur si detyrime afatshkurta, të cilat paraqesin pagesën nga SI për të financuar kostot e dizajnit. Nuk ka regjistrime kontabël tjera lidhur me kontratën me SI.’

Si pjesë e rishikimit të ngjarjeve pas datë së raportimit, nga inspektimi i korrespondencave në mes të Koni dhe SI, tregohet se kontrata ishte anuluar nga SI dhe ata nuk mund të paguajnë për përfundimin e produktit. Duket se SI kishte humbur një vlerë domethënëse të financimit në fund të vitit 2018 gjë që ka ndikuar në pozitën financiare të kompanisë. Menaxheri përgjegjës për kontratën me SI ka konfirmuar se SI kishte informuar atë për vështirësitë financiare me të cilat ballafaqohej në dhjetor të 2018. Çështja ishte diskutuar me drejtorin financiar të Koni i cili kishte theksuar se ishte i kënaqur me trajtimin aktual të kontratës dhe nuk kishte propozuar të bëhej ndonjë korigjim në pasqyra. Drejtori financiar po ashtu këshilloi që humbja nga kontrata me SI të mos përmendet në raportin vjetor të kompanisë, pasi që nuk e konsideronte aq domethënëse për ta diskutuar. Koni aktualisht është duke punuar në gjashtë kontrata për konsumatorët tjerë. Dëshmitë tona të auditimit përfundojnë se Koni nuk ballafaqohet me ndonjë kërcënim të hipotezës së vijimësisë për shkak të humbjes së SI si konsumator.’ Puna juaj lidhur me rishikimin e hipotezës së vijimësisë e mbështet këtë konkluzion.

Kërkohet:

- (i) Komentoni mbi çështjet që duhet të konsiderohen dhe rekomandoni veprimet nga auditori; (7 pikë) dhe
- (ii) Shpjegoni dëshmitë e auditimit të cilat pritni të gjeni në dosjen e auditimit. (5 pikë)

[Total = 25 pikë]

Zgjidhja

(a)

Auditimi i kompanisë nuk duket se është kryer duke respektuar cilësinë e auditimit dhe duket se SNA-të në disa raste janë shkelur.

Materialiteti – nuk është rishikuar më vonë për a mbetur në nivelin e përcaktuar në fazën e planifikimit. SNA 320 Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e auditimit kërkon që auditori të përcaktoj materialitetin për pasqyrat financiare në tërësi në fazën e planifikimit dhe ta rishikoj atë me progresin e auditimit nëse është e nevojshme, kur pranohen fakte të reja. Edhe në rast kur materialiteti nuk ndryshohet, auditori duhet ta rishikoj dhe dokumentoj atë.

Auditimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve

Auditimi i makinës së paketimit nuk është kryer si duhet dhe duket se mungesë të dëshmime të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur përfundimin e auditorit në këtë fushë. Kosto e kësaj pasurie është materiale, bazuar në materialitetin fillestar, prandaj ka rrezik të anomalisë materiale nëse nuk grumbullohen dashmitë e mjaftueshme dhe të përshtatshme. Edhe pse vlera bartëse në fund të vitit është më e ulët se materialiteti, nuk e mohon kërkesën që të grumbullohen dëshmitë e duhura për koston dhe matjen pasuese të një asemi. Makina e paketimit është dashur të verifikohet fizikisht sepse porosia dhe fatura nuk e dëshmojnë ekzistencën e saj. Përveç tjerash, pa e verifikuar fizikisht makinën, nuk mund të dijmë gjendjen e saj dhe nëse është në përdorim dhe nëse duhet të dëmtohet në vlerë në pasqyrat financiare. Mbështetja në kompaninë e shpërndarjes për të ofruar dëshmi për ekzistencën dhe përdorimin të pasurisë është e papërshtatshme. SNA 500 Dëshmitë e auditimit thekson se dëshmitë që pranohen direkt nga auditori janë më të besueshme se ato që merren indirekt. Në këtë rast mund të përdoren konfirmimet e jashtme por ato gjithsesi do të duhej të vërtetoheshin me dëshmi tjera mbështetëse. Marrdhënia në mes të kompanive Sasa dhe Arra duhet të kuptohet nga auditori sepse atomi und të jenë palë të lidhura që do të përcaktonte se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në konfirmimet e jashtme nga Arra.

Numërimi i stokeve

Sa i përket pjesëmarrjes në numërim të stokeve, ekipi i auditimit është dashur të diskutojë mangësitë nëse ato rezultojnë me ndonjë problem më të madh. Duke konsideruar komentin se numërimi nuk ishte organizuar si duhet, me siguri do të thotë se udhëzimet për numërim nuk ishin duke u ndjekur si duhet. Njëra nga kërkesat e SNA 501 Dëshmitë e auditimit – konsiderata specifike për zëra të përzgjedhur është se gjatë pjesëmarrjes në numërim të stokeve, auditori do të vlerësojë edhe udhëzimet e menaxhmentit dhe procedurat për regjistrimin dhe kontrollimin e rezultateve nga numërimi. Nuk është e qartë nga përfundimi i punës së auditimit nëse problemet e vërejtura gjatë numërimit të stokeve janë diskutuar me menaxhmentin. Auditori që ka marrë pjesë në numërim të stokeve është dashur të ngrisë çështjen me menaxhmentin dhe është dashur të vlerësojë nëse nevojitet rinumërimi i të gjitha stokeve. Do të nevojitet trajnim i stafit të auditimit për të siguruar se ata e kuptojnë rolin e auditorit gjatë numërimit të stokeve. Po ashtu mënyra si është kryer numërimi mund të jetë mangësi në kontrollet e brendshme të kompanisë prandaj është çështje që duhet të komunikohet me menaxhmentin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen.

Rishikimi i letrave të punës

Komentet e seniorit të auditimit lidhur me rishikimin nga menaxheri dhe partneri tregojnë se disa elemente të SNA 220 Kontrolli i cilësisë për një auditim të pasqyrave financiare janë shkelur. SNA 220 kërkon që partneri i angazhimit duhet, përmes rishikimit të dokumenteve të auditimit dhe diskutimit me anëtarët e ekipit, të jetë i kënaqur se është grumbulluar dëshmi i mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit për të mbështetur përfundimet dhe opinionin e arritur. Nga rasti duket se partneri nuk ka rishikuar si duhet letrat e punës duke u mbështetur vetëm në komentet nga seniori i auditimit. SNA 220 tregon se partneri i auditimit nuk ka nevojë të rishikojë të gjithë dokumentacionin e auditimit, por ‘një shikim i shpejtë’ i letrave të punës mund të tregojë se fushat që kërkojnë gjykim më të madh nuk janë rishikuar mjaftueshëm. Gjithashtu duket se rishikimi është kryer vetëm afër përfundimit të punës në terren. Rishikimet duhet të kryhen në baza kohore përgjatë tërë auditimit në mënyrë që çfardo problemi të zgjidhet me kohë.

Konsideratat etike

Ekziston një kërcënim i mundshëm ndaj pavarësisë pasi që vëllau i partnerit të angazhimit ju ofron shërbime të konsulencës klientit tonë. Ky është një kërcënim i interesit personal pasi që

vëllau i partnerit pranon para nga klienti. Çështja duhet të hetohet më tutje dhe njëri nga anëtarët senior të firmës së auditimit duhet të diskutoj këto komente për të vlerësuar nëse ka kërcënim ndaj pavarësisë dhe për masat që duhet të ndërmerren. Komentet e partnerit tregojnë mungesë të integritetit dhe duket se ai ka diçka për të fshehur, prandaj ai duhet të largohet nga angazhimi dhe të rishikohet puna e tij.

(b) (i) Çështjet që duhet të konsiderohen

Puna në proces përfaqëson 4.7% të pasurive totale prandaj është materiale për pasqyrën e pozicionit financiar. Të hyrat e shtyra janë po ashtu materiale për shkak se paraqesin 2.7% të pasurive totale. Edhe pse korrespondenca me SI është e datuar pas fundit të vitit, SI ka pasur vështirësi financiare para përfundimit të vitit. Prandaj anulimi i kontratës duket se përmbushë definicionin e ngjarjes kokrrigjuese sipas SNK 10 Ngjarjet pas periudhës së raportimit sepse konfirmon se kushtet kanë ekzistuar në fund të vitit. Menaxhmenti duhet konsideroj nëse ende është e përshtatshme që të njihet puna në proces si pasuri. Sipas SNRF 15 Të hyrat nga kontrata me konsumatorët, kostot e ndodhura për të përmbushur kontratën njihen si pasuri nëse dhe vetëm dhe nëse përmbushen kriteret në vijim:

- Kostot kanë të bëjnë direkt me kontratën (ose një kontratë specifike të pritur);
- Kostot gjenerojnë ose rrisin burimet e entitetit të cilat do të përdoren në përmbushjen e një obligimit të performancës në të ardhmen; dhe
- Kostot pritet të rikupërohen.

Anulimi i kontratës tregon se kostot e punës në process nuk janë të rikuperueshme nga SI, dhe në këtë rast duhet të shlyhen. Menaxhmenti nuk është duket planifikuar të ndryshojë sallon në fund të vitit, prandaj ekipi i auditimit duhet të hetoj për arsyet. Nëse menaxhmenti mendon të përdor dizjantin për ndonjë kontratë tjetër, auditori duhet të sigurohet se nuk ka pengesa nga SI në formë të të drejtave për të penguar përdorimin e këtij dizjanti për ndonjë kontraktor tjetër.

Nëse puna në dizjan rezulton me aftësinë për të zhvilluar një lloj tjetër të produktit për një konsumator tjetër, atëherë këto kosto mund të kapitalizohen sipas SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara. Kjo duhet të diskutohet me menaxherin e projektit dhe drejtorin financiar për të vlerësuar nëse përmbushen kriteret e SNK 38.

Trajtimi kontabël i të hyrave të shtyra po ashtu duhet të konsiderohet. Varësisht nga kushtet e kontratës me SI, shuma mund të jetë e ripagueshme, edhe pse ky nuk është rasti pasi që SI vet e ka anuluar kontratën. Nëse ndonjë pjesë duhet të ripaguhet (kthehet) atëherë ajo duhet të mbetet në detyrimet afatshkurta dhe pjesa tjetër të kaloj përmes pasqyrës së të ardhurave. Nëse kostot nuk mund të kapitalizohen, atëherë duhet të njihet një humbje në PA. duke supozuar se pagesa në avans nuk është e rikthyeshme, pozicioni neto i kostos së zhvillimit dhe të hyrave të shtyra është një humbje prej €150,000. Kjo përfaqëson 15.8% të fitimit të vitit dhe është materiale. Për shkak se çështja është materiale, anulimi i kontratës duhet të shpaloset edhe në raportin vjetor të kompanisë. Auditori duhet të konsideroj përgjegjësitë sipas SNA 720 Përgjegjësitë e auditorit lidhur me informatat tjera në dokumentet që përmbajnë pasqyrat financiare. SNA 720 kërkon që auditori të lexoj informatat tjera për të identifikuar ndonjë moskonsistencë me pasqyrat e audituara financiare. Varësisht nga materialiteti i mokonsistencës auditori mund të kërkojë që ato informata të korrigjohen ose të rezervoj opinionin.

(ii) Dëshmitë

- Kopja e kontratës në mes të Koni dhe SI për të rishikuar kushtet, anulimin, ripagimin, pronësinë e të drejtave të dizajnit, etj.
- Kopjet e korrespondencës në mes të Koni dhe SI lidhur me anulimin e kontratës.

- Konfirmimet e shkruara nga SI që kontrata është anuluar dhe datën e anulimit.
- Përfaqësimet e shkruara nga menaxheri i projektit për të konfirmuar se SI e ka kontaktuar atë në dhjetor, para fundit të vitit.
- Shënimet e diskutimeve me menaxherin e projektit për të konfirmuar se puna në process mund të përdoret në kontratë tjetër dhe mund të çoj në zhvillimin e produktit të ri.
- Korrespondencat me këshilltarin ligjor lidhur me pronësinë e të drejtave dhe nëse ka ndonjë implikim ligjor
- Ekstraktet nga pasqyrat financiare për të konfirmuar se janë bërë korrigjimet e duhura.
- Një kopje e raportit vjetor për të rishikuar nëse është shpalosur anulimi i kontratës me SI.

Detyra 3

(a) Sipas SNA 240 Përgjegjësitë e auditorit lidhur me mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare: 'Gjatë identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut të anomalive materiale për shkak të mashtrimit, në bazë të supozimeve se ka rrezik të mashtrimit në njohjen e të hyrave, auditori duhet vlerësoj llojet e të hyrave, transaksionet e të hyrave ose pohimet që ndikojnë në rritjen e rrezikut të tillë.'

Kërkohet: Diskutoni pse auditori duhet të supozoj se ka rrezik të mashtrimit në njohjen e të hyrave dhe pse SNA 240 kërkon përgjigje specifike nga auditorit lidhur me rreziqet e identifikuar. (7 pikë)

(b) Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Joki, një zingjir i klubeve të fitnesit që zotërohet dhe menaxhohet nga biznesmeni Bekë Ibishi. Auditimi për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018 është afër përfundimit dhe pasqyrat draft paraqesin pasuri totale prej €27 milion dhe fitim para tatimit prej €2.2 milion. Seniori i auditimit ju ka lënë shënimet në vijim për tu konsideruar nga ju:

(i) Transferet me para

Gjatë rishikimi të librit të arkës, një arkëtim prej €350,000 ishte shoqëruar me përshkrimin 'AB'. Pasqyra e bankës tregonte se një ditë pas gati e njëjta shumë ishte transferuar në një bankë të kompanisë në një vend jasht shtetit. Kur e pyeta shefin e kontabilitetit për këtë çështje, ai tha se duhej të bisedoja me Zt. Rama, pasi që ai ka përgjegjësinë e vetme për menaxhimin e parasë. Sipas Zt. Rama, një shok i vjetër i tij Armend Berisha i kishte huazuar këto para kompanisë për të financuar zgjerimin e mëtutjeshëm të kompanisë. Dëshmitë lidhur me këto pohime i janë kërkuar Zt. Rama mirëpo ai ende nuk ka dërguar diçka te auditorët. (7 pikë)

(ii) Çështja gjyqësore

Në fund të vitit Jork Sha e çregjistroi një provision që kishte të bënte me një çështje gjyqësore në vijim me një ish të punësuar i cili kërkonte €150,000 për largim jo të drejtë nga puna. Ky provision ishte njohur në pasqyrat financiare të vitit që përfundoi me 31 dhjetor 2017 por ishte çregjistruar sepse Zt. Rama besonte se tani kompania ka gjasë të madhe të fitoj rastin në gjykatë. Zt. Rama nuk ishte në dispozicion të diskutonte këtë çështje dhe nuk ka ndonjë dëshmi shtesë të dokumentuar që nga viti i kaluar. Raporti i auditimit nuk ishte modifikuar vitin e kaluar.

(6 pikë)

Kërkohet:

Vlerësoni implikimet e çështjeve të mësipërme në përfundimin e auditimit, duke rekomanduar veprime të mëtutjeshme që duhet të ndërmirren nga firma e auditimit.

[Total = 20 pikë]

Zgjidhja

(a) Ka një numër të arsyeve pse duhet supozuar se ka rrezik të mashtrimit në njohjen e të hyrave. Njëra arsye është se menaxhmenti i kompanisë shpesh është nën presion, sidomos kompanitë e listuara, të arrijnë caqe të caktuara të fitimit. Arritja e këtyre caqeve shpesh ndikon në vendet e tyre të punës dhe kompenzimin. Këto caqe të performancës shpesh përfshijnë matjen e rritjes së të hyrave, duke i ofruar kështu menaxhmentit motiv për të përdorur teknika për mbivlerësimin e të hyrave. Në kompanitë tjera mund të ketë motive tjera, siç është nënvlerësimi i të hyrave për qëllime tatimore.

Transaksionet e të hyrave zakonisht janë me vëllim të mdh dhe kjo e bën më të vështirë zbulimin e mashtrimit ose gabimit duket përdorur teknikat tradicionale të mostrimit.

Njohja e të hyrave po ashtu mund të jetë një fushë që kërkon më shumë gjykim. Shembuj përfshijnë: njohja e kontratave afatgjata, siç është ndërtimi apo ofrimi i shërbimeve. Këto kërkojnë vlerësimin e përqindjes së kompletimit në fund të periudhës, që e rrit gjasën për manipulim nga menaxhmenti. Përveç kërkesës për gjykim, njohja e të hyrave mund të jetë çështje komplekse. Për shembull, disa shitje kanë elemente të shumfishtë, siç është rasti i produkteve dhe shërbimit të mirëmbajtjes. Në disa kompani një pjesë e madhe e të hyrave mund të jetë nga shitjet me para të gatshme. Në këtë rast rritet rreziku i vjedhjes së paras dhe pastaj manipulimi i të hyrave për të fshehur krimin. Deri sa njohja e të hyrave në përgjithësi mund të konsiderohet si rrezik i lartë, nuk është gjithmonë ashtu, kompanitë me një rrjedhë të thjeshtë të të hyrave ose me vëllim të ulët të transaksioneve mund të konsiderohen si rrezik i ulët i mashtrimit.

(b) (i) Transferet me para

Kjo është e pazakont, transferet e pashpjeguara në një bankë të huaj tregojnë se pronari është duke përdorur kompaninë e tij për të pastruar para. Ka gjasë që të hyrat nga aktivitetet kriminale janë vendosur në llogarinë e bankës së kompanisë për të mundësuar transferin në një llogari të huaj për tu dukur se janë para legjitime. Fakti se pronari ka përgjegjësinë e vetme për menaxhimin me paranë dhe se shefi i kontabilitetit nuk ka mbikëqyrje ose përfshirje, tregon kontrolle të dobëta mbi paranë dhe ndarje jo të duhur të detyrave, që mund të jetë edhe qëllimi i pronarit. Pamundësia për të dokumentuar transaksionin, rritë edhe më shumë dyshimin për aktivitet kriminal. Ka mundësi që kompania është duke u përdorur si mjet për pastrim parash pa dijeninë e pronarit. Ka gjasë që paraja është pranuar në mirëbesim pa u verifikuar burimi i të ardhurave. Shuma e transferuar paraqet 1.3% të pasurive totale dhe është materiale për PF. Angazhimi dhe çështjet tjera rreth parasë tani duhet të konsiderohen me rrezik të lartë dhe të përdoret një shkallë e lartë e skepticizmit profesional. Dosjet e auditimit duhet t'i nënshtrohen një rishikimi të dytë të pavarur. Firma duhet të kërkojë këshilla ligjore për shkak të aktivitetit të mundshëm kriminal. Situata duhet të raportohet sa më parë te Zyrtari i Raportimit për Pastrim të Parave. ZRPP duhet të vlerësoj raportet për pastrim të parave dhe nëse kërkohet të raportoj këtë tek autoritetet përkatëse.

(ii) Çështja ligjore

Krijimi i provizionit dhe çregjistrimi zakonisht përdoret si teknikë e kontabilitetit 'kreativ'. Prandaj, kjo është një fushë me rrezik të lartë. Çregjistrimi i provizionit në vitin aktual e rritë fitimin para tatimit me €150,000, që përfaqëson 6.8% të fitimit. Prandaj kjo është materiale dhe duhet të trajtohet me skepticizëm profesional.

Në pajtueshmëri me SNK 37 Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente, provizioni duhet të njëjtoj nëse:

- kompania ka pasur një obligim si rezultat i një ngjarje në të kaluarën;
- nëse është konsideruar si e mundshme se do të ndodhë një dalje e parasë; dhe
- nëse mund të bëhet një vlerësim i besueshëm për shumën e detyrimit.

Duke konsideruar se kjo është një shumë materiale, duhet të ketë dëshmi të auditimit në dosjen e auditimit të vitit të kaluar për përshtatshmërinë e shumës së regjistruar. Do të ishte maturi të rishikohet dosja e vitit të kaluar. Në rastet gjyqësore, auditori zakonisht pret të ketë dëshmi të dokumentuara ngë formën e korespondencave me avokatët, paditë ose pretendimet e shkruara, etj. Ka pak gjasa që supozimet e menaxhmentit dhe përfaqësimet e shkruara të jenë konsideruara si të përshtatshme në një çështje ku kërkohet ekspertiza ligjore. Për arsyen e njejtë ka pak mundësi që pohimet e pronarit të konsiderohen si dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Mungesa e pronarit për të diskutuar për çështjen ngrit edhe më shumë dyshimet. Menaxheri i auditimit duhet të kërtojë konfirmim me shkrim nga avokatët e kompanisë (përmes klientit). Nëse nuk mund të grumbullohen dëshmitë e mjaftueshme për këtë ngjarje, atëherë provizioni duhet të mbetet në pasqyrat financiare.

Detyra 4

Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e grupit POPO dhe jeni duke përfunduar auditimin e pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018. Pasqyrat financiare të konsoliduara draft paraqesin të hyra prej €18 milion (2017 – €17 milion), fitim para tatimit prej €2 milion (2017 – €3 milion) dhe pasuri totale prej €58 milion (2017 – €59 milion). Firma juaj auditon të gjithë komponentët (filialat) e grupit, përveç filialës jashtë vendit, TYTY Co, e cila auditohet nga një firmë e vogël e auditimit në atë shtet. Seniori i auditimit ju ka lënë një shënim për ta rishikuar. Ju jeni në dijeni se raporti vjetor i grupit dhe pasqyrat financiare do të publikohen javën e ardhshme, dhe grupi nuk do të jetë i gatshëm të bëjë ndonjë korrigjim në pasqyrat financiare lidhur me çështjet që janë përshkruar.

(a) TYTY Co

Auditorët e komponentës (filialit) TYTY janë udhëzuar nga auditori i grupit të ofrojnë detaje për rastin gjyqësorë i cili është në vijim. Një ish-punëtor është duke paditur TYTY për shkarkim të padrejtë nga puna dhe ka kërkuar €500,000 si dëmshpërblim. Për të qenë në pajtueshmëri me legjislacionin vendor, pasqyrat financiare individuale të TYTY janë përgatitur duke përdorur standardet vendore të kontabilitetit. Sipas këtyre standardeve, provizioni njihet vetëm nëse është shumë e sigurt që të ndodhë pagesa e provizionit. Auditorët e filialit kanë marrë konfirmim verbal nga këshilltarët ligjor të TYTY se dëmi është i mundshëm mirëpo nuk ka siguri të plotë se do të ketë dalje të parasë prandaj nuk është bërë provision as në pasqyrat financiare individuale as në ato të grupit. Nuk është marrë ndonjë dëshmi tjetër të auditimit nga auditorët e filialit lidhur me rastin.

(7 pikë)

(b) Llogaritë e arkëtueshme

Me 1 shkurt 2018 është pranuar një kërkesë nga administratori që merret me falimentimin e kompanisë Arbi Shpk. Kërkesa thekson se kompania është në gjendje të paguaj rreth 10% për të pagueshmet e veta. POPO që është kompania prind e grupit ka rreth 1.6 milion Euro në llogari të arkëtueshme nga Arbi Shpk.

(7 pikë)

(c) Deklarata e kryesuesit të bordit të kompanisë

Deklarata draft e kryesuesit të bordit të kompanisë POPO që do të përfshihet në raportin vjetor të kompanisë, është pranuar dje. Kryesuesi në deklaratë në mes tjerash thekson se është i kënaqur se të hyrat e kompanisë janë rritur me 20% këtë vit.

(6 pikë)

Kërkohet: Lidhur me secilën çështje të përshkruar:

- (i) Vlerësoni implikimet në përfundimin e auditimit të Grupit, duke shpjeguar çfardo korrigjimi që do të jetë i nevojshëm në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe duke rekomanduar procedurë të mëtutjeshme nëse është e nevojshme; dhe
- (ii) Përshkruani ndikimin në raportin e auditimit të Grupit nëse këto korrigjime nuk bëhen.

[Total = 20 pikë]

Zgjidhja

(a) TYTY

Shuma e pretenduar ndaj TYTY është material për fitimin e konsoliduar, duke përfaqësuar 25 të fitimit para tatimit. Shuma nuk është material në pasuritë e konsoliduara që përfaqëson 1% të asaj shume. Të njëjtat politika të kontabilitetit duhet të palikohen në tërë Grupin në pasqyrat financiare të konsoliduara. Prandaj në pajtueshmëri me SNK 37, duhet të njihet një provision në pasqyrat financiare të konsoliduara nëse shuma ka gjasa të paguhet. Korrigjimi i duhur është D. Shpenzimet operative €500,000
K, Detyrimet qarkulluese €500,000

Dëshmia e auditimit nga auditori i komponentës është e pamjaftueshme. Dëshmia verbale nuk është burim i besueshëm i dëshmive. Duhet të kryhen dëshmi të mëtutjeshme të auditimit, përfshirë:

- Përfsoni dëshmi të shkrua nga këshilltarët ligjor të TYTY përfshirë një deklaratë mbi opinionin e tyre për mundësinë e pagesës dhe bazën për atë opinion;
- Rishikoni pretendimin për të konfirmuar se shuma prej €500,000 është shumë e saktë;
- Inspektoni procesverbalet e takimi të drejtorëve të TYTY për dëshmi të diskutimit të pretendimit dhe për të përfutur dëshmi për arsyen e këtij pretendimi dhe pse kontestohet nga TYTY.

Këto procedura të mëtutjeshme të auditimit duhet të kryehen nga auditori i komponentës ose nga ekipi i auditimit të Grupit. Nëse pasqyrat kanë nevojë të korrigjohen dhe mbesin të pakorrigjuara atëherë pasqyrat pëmbajnë anomali material. Kjo mund të rezultojë me opinion me rezervë për shkak të anomalisë material por jo përhapëse. Në pasjtueshmëri me SNA 705 Modifikimet në Opinionin e auditorit, raporti duhet të përmbajë një paragrafë shtesë 'Baa për rezervimin e opinionit' në të cilin përshkruhet çështja që ka shkaktuar rezervimin e opinionit. Duhet po ashtu të kuantifikohet efekti i anomalisë material.

(b) Llogaria e arkëtueshme

Llogaria e arkëtueshme është material për pasqyrat financiare të konsoliduara, që përfaqëson 2.85 të pasurive dhe 80% të fitimit para tatimit. Shuma që ka gjasë të mos arkëtohet është 90% e shumës së papaguar, dmth €1.44 milion. Edhe kjo shumë është material që përfaqëson 2,5% të pasurive dhe 72% të fitimit para tatimit. SNRF 9 Instrumentat financiar kërkon që llogaritë e arkëtueshme të dëmtuara të njihen sipas vlerës së drejtë që është vlera e tanishme e rrjedhës së parashë së vlerësuar. Në pajtueshmëri me informatat e ofruara nga administratori i Arbi, ka mundësi që shuma prej 10% të paguhet ndërsa mbetja prej 90% duhet të shlyhet. Korrigjimi i duhur është:

D. Shpenzimet operative (borxhi i keq) €1,440,000

C. Llogaria e arkëtueshme €1,440,000

Shuma duhet të korrigjohet në pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2014, Nëse pasqyrat financiare nuk korrigjohen pasuritë qarkulluese dhe fitimi do të mbivlerësohen për €1.44 milion. Kjo është shumë domethënëse dhe korrigjimi do të ndikojë shumë në fitim.

Auditori duhet të kryejë procedura shtesë si vijon:

- Përfitimi i njoftimit nga administratori i Arbi se kompania është josolvente dhe se vetëm 105 të borxhit do të paguhet;
- Përfitimi i konfirmimit të shkruar nga administratorët që tregojn kohën e pritur të pagesës;
- Kontrollimi i inkasimeve pas fundit të vitit për të parë nëse është inkasuar ndonjë shumë nga AArbi;
- Rillogaritja e humbjeve nga dëmtimet dhe gjurmimi deri në librin kryesor dhe në pasqyra financiare. Nëse pasqyrat financiare nuk korrigjohen, të dy pasqyrat edhe ajo e pozicionit edhe e të ardhurave do të përmbajnë anomali, prandaj auditori duhet të jap një opinion me rezervë.

Ndikimi i agreguar në pasqyrat financiare

Materialiteti dhe madhësia e të dy çështjeve të diskutuara më sipër duhet të konsiderohet e agreguar. Kur kombinohen, korrigjimet e kërkuara në psuri neto dhe shpenzime operative janë €1.94 milion. Ky korrigjim do të zvogëlojë fitimin e konsoliduar para tatimit për vetëm €60,000. Anomalia e kombinuar mund të konsiderohet edhe materiale edhe përhapëse prandaj nëse pasqyrat financiare nuk korrigjohen atëherë auditori duhet të jap një opinion kundër, të përfshihet paragrafi i 'Bazës për opinion kundër' në të cilin shpjegohet arsyeja që ka çuar në këtë opinion.

(c) Deklarata e kryesuesit

SNA 720 Përgjegjësia e auditorit lidhur me informatat tjera në dokumentet që përmbajnë pasqyrat financiare të audituara kërkon nga auditori të lexojë informatat tjera, të definuara si informata financiare dhe jofinanciare që janë të përfshira në dokumente që përmbajnë pasqyrat financiare dhe raportin e auditorit. Qëllimi i leximit të këtyre informatave shtesë është identifikimi i jokonsistencës me informatat në pasqyrat financiare të audituara. Një jokonsistencë material paraqitet kur informatat janë kontradiktore me ato të paraqitura në pasqyrat financiare dhe të cilat mund të ngrejë dyshime në opinionin e auditorit. SNA 720 kërkon që nëse zbulohen jokonsistenca në informata auditori duhet të përcaktoj nëse pasqyrat financiare ose informatat tjera duhet të rishikohen. Në rastin e Grupit, deklarata e kryesuesit përmban jokonsistencë pasi që sipas pasqyrave financiare, të hyrat janë rritur për 5.9% por kryesuesi deklaron se ato janë rritur për 20%. Puna e auditorit në të hyra duhet të rishikohet për të siguruar se është përftuar dëshmi e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit për të mbështetur shumat në pasqyrat financiare. Kjo çështje duhet të diskutohet me menaxhmentin dhe duhet të kërkohej të korrigjoet deklarata e kryesuesit. Menaxhmentit duhet ti prezantohet puna e auditimit për ta arsyetuar këtë ndryshim. Përfshirja e një shumë të pasaktë në deklaratën e kryesuesit në raporte mund të jetë gabim në të cilin rast menaxhmenti do ta ndryshojë. Nëse menaxhmenti refuzon ta korrigjojë këtë çështje, atëherë raporti i auditorit duhet të përfshijë paragrafin Çështjeve tjera. Ky paragraf vendoset mënjherë pas paragrafit të opinionit dhe në të përshkruhet jokonsistenca në fjalë. Kjo çështje po ashtu duhet ti komunikohet personave të ngarkuar me qeverisjen.

Detyra 5

Ju jeni menaxher në firmën e auditimit Mona e cila ka tre zyra dhe 12 partnerë. Rreth 1/3 e klientëve të firmës janë klient të auditimit, pjesa tjetër janë klient të cilëve firma ju ofron shërbime të tatimeve, kontabilitetit dhe konsulencë biznesore.

Firma është duke konsideruar si të gjenerojë më shumë të hyra dhe nga ju është kërkuar të vlerësoni propozimin e bërë nga menaxheri i zhvillimit të biznesit.

Propozimi 1:

Mund të vendoset një reklamë në gazetat ditore për të tërhequr klient të rinj. Drafti i reklamës është dhënë për tu rishikuar nga ju:

Mona është firma më e madhe dhe ofruesja më profesionale e shërbimeve të kontabilitetit dhe auditimit. Ne ofrojmë një gamë të shërbimeve përveç auditimit, të cilat garantojnë të përmirësojnë efikasitetin e biznesit tuaj dhe ju kursejnë tatimet.

Nëse jeni të pakënaqur me auditorët tanë, ne mund të ofrojmë një opinion të dytë mbi raportin të cilin ju kanë ofruar.

Ofertë: për të gjithë klientët e rinj, ofrojmë 25% zbritje në rast se ju ofrohet auditimi dhe shërbimet e tatimeve. Tarifat tona janë të aprovuara nga ShKÇAK.

Kërkohet:

Vlerësoni propozimin e mësipërm duke komentuar mbi çështjet etike dhe profesionale.

[Total = 10 pikë]

Zgjidhja

Zgjidhja

(a) (i) Reklamimi nuk ndalohet nga Kodi i Etikës së IFAC. Mirëpo Kodi thekson se kontabilistët profesionist nuk duhet të dikreditojnë profesionin kur reklamojnë shërbime profesionale. Kontabilisti profesionist në praktikën publike duhet të jetë i ndershëm dhe i sinqertë kur bën reklama për shërbime dhe nuk duhet:

- Të bëjë pretendime të ekzagjeruara për shërbimet që ofron, kualifikimet që posedon ose përvojën që ka;
- Të jetë çorientuese as direkt as të perceptohet;
- Të bëjë referenca nënçmuese ose krahasime tëpabazuara me punën e tjetrit.

Përveç konsiderimit të çështjeve më sipër, firmat e auditimit/kontabilitetit duhet të sigurojnë se reklamat janë në pajtueshmeri me rregullat vendore.

Reklama e firmës fillon me pretendimin se firma është më e madhja në vend. Firma ka vetëm tre zyra dhe 12 partner, dhe do të ishte çorientuese të pretendohet se është më e madhja në vend. Po ashtu pretendohet se firma është 'më profesionalja'. Ky pretendim është vështë të provohet dhe mund të jetë çorientuese pasi që publiku mund ta perceptoj se ajo firmë është 'më e mirë' se firmat tjera.

Reklama pretendon se shërbimet e firmës garantojnë përmirësimin e efikasitetit të biznesit. Kjo nuk mund të garantohej, prandaj reklama nuk është e ndershme. Gjthashtu, firma garanton se do të kursej taksa për klientët. As kjo nuk mund të garantohej sepse secili klient individual ka çështje të ndryshme tatimore dhe vetëm përmes hetimit të detajuar mund të përcaktohet kursimi i tatimeve.

Gjithashtu, pretendimet rrisin rrezikun se firma mund ti ekspozohet padive gjyqësore, pasi qe nese klientët që angazhojnë firmën nuk shohin përmirësim të efikasitetit të biznesit ose ulje të tatimeve, mund ta padisin firmën në gjyq.

Opinionet e dyta nuk janë të ndaluara por është e pazakont për klientët të kërkojnë opinione të dyta dhe është ekstremisht e pazakont të reklamohet ky shërbim. Reklamimi nenkupton se firma mund të ofroj opinion'më të mirë' se firmat e tjera, që është tepër joprofesionale dhe pa integritet. Po ashtu reklama nënkutpon për publikn se është normale të kërkohe opinion i dytë.

Ofrimi i një tarife hyrëse nuk është e ndaluar. Mirëpo, tarifat duhet të llogariten bazuar në kohën që nevojitet për të kryer një angazhim për të siguruar se është ofruar shërbim me cilësi. Ofrimi i një zbritje prej 25% mund të rezultojë me punë me cilësi të dobët.

Po ashtu nuk është e mençur që firma të ofroj zbritje pasi që ofrohen dy shërbime e sidmos ato tek të cilat mund të lind kërcënimi i pavarësisë nga vetrishikimi dhe avokimi.

Reklama pretendon se tarifat e firmës janë të aprovuara nga ShKÇAK. Ky është pretendim i rrejshëm pasi që ShKÇAK nuk monitoron e as nuk aprovon tarifa të shërbimeve, dhe në këtë rast është duke u shfrytëzuar brendi i 'SHKÇAK' që është shumë joprofesionale. Kjo mund të çoj në veprime disiplinore kundër partnerëve individual të firmës nga ShKÇAK.